



Prishtinë: 05.06.2019
Kodi i ZRRE-së: V_1162_2019

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1932_04_19**;
- Ankesa e KESCO-së e datës **23.05.2019**.

në seancën e mbajtur më datë 05.06.2019, nxori këtë:

V E N D I M

- I **REFUZOHET** ankesa e KESCO-së ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin M. M. parashtruesi B. P.) nga Prizreni me shifër të konsumatorit DPZ 3560, si e pa bazuar.
- II **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. **ZRRE/DMK_V_1932_04_19** i datës 26.04.2019.

A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 30.04.2019 ka pranuar ankesën e parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së, i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE si vendim i shkalës së parë për këto shkaqe: Përfaqësuesi i KESCO-së, në ankesë ka theksuar se KESCO në bazën e të dhënave të regjistruar si konsumator ka M. M. me shifër DPZ – 3560. KESCO ka theksuar se blerësi i ri B. P. me rastin e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme nga pronari J. K. me datë 05.08.2014 ka bartur të drejtat dhe detyrimet për pronën e re, kjo e rregulluar me Ligjin për Marrëdhëniet Detyimore tek pjesa e kontratave ku specifikohet fakti se blerësi me blerje i pranon të drejtat dhe detyrimet, pra blerësi ka ble pranon me ngarkesë. KESCO në ankesë ka theksuar se e ka ngarkuar konsumatorin edhe ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike (rikthim i humbjeve) për shkak të asgjësimit të njehsorit. KESCO në ankesë ka theksuar se nuk ka pranuar asnjë dokument zyrtar qoftë nga gjykata apo Agjensia Kosovare për Prona që dëshmon se M. M. ka qenë uzurpator. KESCO në ankesën e tyre kanë theksuar se kërkojnë nga Bordi i ZRRE-së që anulojë vendimin e DMK-së ZRRE/DMK_V_1932_04_19 i datës 26.04.2019 për konsumatorin M. M. (parashtruesi B. P.) me shifër DPZ - 3560 dhe të mbetet në fuqi përgjigja e KESCO-s e datës 10.03.2017.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 05.06.2019 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.



Sa i përket pikës së kundërshtimit të KESCO-s se KESCO në bazën e të dhënave të regjistruar si konsumator ka M. M. me shifër DPZ – 3560, Bordi i ZRRE-së thekson se shifra e konsumatorit DPZ – 3560 është e regjistruar që nga fillimi dhe se ka filluar të faturohet me fatura të energjisë elektrike me shpenzime që nga fillimi deri më 08/2014, ku borxhi deri në këtë periudhë është 3,385.14€, ndërsa nga periudha 09/2014 e deri më 03/2016 është faturuar pa shpenzime por vetëm me taksa, ndërsa nga periudha 04/2016 prapë është faturuar me shpenzime të energjisë elektrike. Bordi i ZRRE-së bazuar në shkresat e lëndës thekson se shifra e konsumatorit DPZ – 3560 është e regjistruar në emër të M. M.. Pra duhet theksuar se KEK atëkohë e tani pastaj edhe KEDS dhe KESCO kanë pasur të gjithë të drejtën ligjore dhe rregullative që të inkasojnë borxhin e energjisë elektrike nga personat të cilat e kanë shkaktuar borxhin dhe jo nga personat me të cilat me dokumente zyrtare dëshmohet se nuk e kanë krijuar atë borxh të energjisë elektrike.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të KESCO-s se blerësi i ri B. P. me rastin e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme nga pronari J. K. me datë 05.08.2014 ka bartur të drejtat dhe detyrimet për pronën e re, kjo e rregulluar me Ligjin për Marrëdhëniet Detyimore tek pjesa e kontratave, Bordi i ZRRE thekson se gjatë analizës së bërë Kontratës mbi shitblerjen e paluajtshmërisë me këste të datës 05.08.2014 kjo nuk qëndron. Bazuar në kontratën mbi shitblerjen e paluajtshmërisë me këste, me të cilën vërehet se kjo kontratë është nënshkruar me datë 05.08.2014 në mes të J. K. (shitësi) dhe B. P. (blerësi) theksohet qartë se shitësi garanton se ndaj kësaj paluajtshmërisë nuk ekziston ndonjë pretendim pronësor-juridik, e njëjta nuk është nën hipotek apo në ndonjë ngarkesë tjetër reale ose detyimore dhe se nuk ka asnjë pengesë të regjistruar apo të paregjistruar lidhur me të. Pra, sipas kësaj kontrate vërehet qartë se blerësi nuk merr për sipër asnjë detyrim deri para kësaj date, dhe se deri më datën e kontratës të gjitha detyrimet i merr shitësi. Bordi i ZRRE thekson se bazuar në shkresat e lëndës vjen në përfundim se KESCO në momentin kur e detyron konsumatorin për pagesën e borxhit të energjisë elektrike në vlerë prej 3,388.04€ ka rënë në kundërshtim me ligjet dhe rregullat në fuqi pasi që këtë borxh është dashtë ta inkasoi nga personat të cilët e kanë bërë shpenzimin e energjisë elektrike. Edhe në rast të pamundësisë së inkasimit të rregullt të këtij borxhi KEK dhe më pas KESCO ka mund ta kërkojë borxhin edhe përmes procedurës gjyqësore.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të KESCO-s se nuk ka pranuar asnjë dokument zyrtar qoftë nga gjykata apo Agjensia Kosovare për Prona që dëshmon se M. M. ka qenë uzurpator, Bordi i ZRRE-së thekson bazuar në shkresat e lëndës shihet qartë se pronar më herët i kësaj prone të paluajtshme ka qenë J. K. dhe kjo sipas Kontratës mbi shitblerjen e paluajtshmërisë me këste të datës 05.08.2014, ndërsa në KESCO si konsumator është i regjistruar M. M. dhe se KESCO nuk ka ofruar asnjë dëshmi se si është bërë regjistrimi i njehsorit elektrik në emër të M. M. kur shihet se prona ka qenë e një personi tjetër, pra pavarësisht se a ka ndonjë dokument për uzurpim apo jo shihet qartë se M. M. nuk ka qenë pronari i pronës së paluajtshme.

Bordi i ZRRE gjatë analizës së bërë shkresave të lëndës konstaton se sipas nenit 5 paragrafi 1 nënparagrafi 1.5 të Rregullës për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji theksohet: se të gjithë konsumatorit kanë të drejtë dhe obligim të *“paguajnë për energjinë e shfrytëzuar, sipas kontratës për Furnizim me Energji të lidhur me Furnizuesin e Energjisë, si dhe për tarifat për shfrytëzim të sistemit të miratuara nga ZRRE-ja”*. Gjithashtu neni 5 paragrafi 2 nënparagrafi 2.4 të kësaj Rregulle thekson se *“furnizuesi duhet të faturojë dhe të arkëtojë (mbledh) pagesat prej konsumatorëve”*, e që në rastin e konsumatorit Furnizuesi nuk ka vepruar konform kësaj dispozite pasi që nuk ka arrit të inkasoj borxhin e krijuar ashtu siç përcaktohet me këtë rregull.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të KESCO-s lidhur me atë se konsumatorin e ka ngarkuar edhe ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike (rikthim i humbjeve) për shkak të asgjësimin të njehsorit, Bordi i ZRRE-së thekson nuk kemi mandat ligjor për shqyrtimin dhe zgjidhjen e



kësaj ankese për faktin se sipas dispozitave të nenit 4 paragrafi 2 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë theksohet: **“Çdo ankese ose kontest që lidhet me elementet e veprës penale, vjedhje e energjisë elektrike, të përcaktuara në nenin 61 të Ligjit për Energji Elektrike, si dhe me dispozitat ligjore siç përcaktohen në Kapitullin e XXVI të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Veprat Penale kundër Shërbimeve Komunale, ku përfshihet edhe vjedhja e energjisë termike (ngrohje qendrore) janë nën juridiksionin e gjykatës kompetente, andaj këto ankesa ose konteste nuk trajtohen në këtë rregull”.**

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 05.06.2019 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Arsim Janova, u.d. kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- KESCO-së, dhe
- Konsumatorit M. M. (parashtruesi B. P.) dhe
- Arkivit të ZRRE-së.